



BASHKIA SKRAPAR

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Rikualifikim i urës së Çorovodës

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34993000-4,
45454100-5**

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 927 256,77 (tremilion e nëntëqind e njëzetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH,**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Për pikën a.- në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26; për pikën b.-në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 83 “Sigurimi i ofertës”, pika 1 dhe 2, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, 2 dhe 3.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo kërkesë konsiderohet e plotësuar, nëse operatori ekonomik ofertues, është kualifikuar për kriteret e përgjithsme të kualifikimit, të përshkruara në pikën 1, sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të dorëzuar prej tij, në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar për një periudhë deri në 2 (dy) vitet e fundit financiare (2023, 2024), ku vlera e xhiros, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të fondit limit të objektit të prokurimit.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pika 1 dhe pika 2, gërma b) dhe pika 3, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për dy vitet financiare (2023, 2024), që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 39, 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Njësia e prokurimi e vlerëson te nevojshme kriterin për xhiron mesatare, dorëzimin e dokumentit përkatës vërtetimit ose pasqyrat financiare vjetore, pasi vërtetojnë kapacitetet ekonomike, financiare të operatorit ekonomik me qëllim përmbushjen dhe realizimin e kontratës. Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilance apo pasqyra financiare për tre vite buxhetore i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatoreve ekonomike dhe të mundësisë se tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv dhe gjendja financiare bankare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar të operatorit ekonomik.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e vitit 2024 dhe ato të maturuara për vitin 2025. *Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar apo ka ushtruar aktivitet sipas QKB-së*

Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025 **(në seksion të veçantë nga taksat dhe detyrimet tatimore në formularin e deklarimit nr.8).**

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK..

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Shlyerja e detyrimeve vendore për operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik, në përputhje me kuadrin ligjor për taksat dhe tarifat vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme :

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllëgaritur të fondit limit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, si dhe:

- Situacionin përfundimtar të punimeve (për të vërtetuar natyrën e punës së kryer)

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore, si dhe:

- Situacionin përfundimtar të punimeve (për të vërtetuar natyrën e punës së kryer)
- **2.3.1.a** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar, për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- **2.3.1.b** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 germa a), plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. Licenca profesionale

Operatori ekonomik ofertues, duhet të zotërojë licencë profesionale në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, e cila të përmbajë kategoritë si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P – 4 A** Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale
- N.P - 11 A** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

PUNIME SPECIALE NË NDËRTIM

- N.S - 6 A:** Sinjalistika rrugore jodriçuese
- N.S –10 A:** Shtresa dhe mbistruktura speciale

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit, që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kritere të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane., VKM-së nr.759/2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim". Licencat janë të lidhura ngushtësisht me punimet e ndërtimit dhe projektin e zbatimit dhe Ligjit nr. 10081 date 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, si dhe në përputhje me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve. Në grafikun e punimeve që jepet bashkëlidhur janë argumentuar licencat e kërkuara.

Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Analiza	Argumentimit i analizës	Niveli i shoqërisë	Argumentimi i nivelit të licencës sipas VKM.42
---------	-------------------------	--------------------	--

N.P. 4	Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërrhyrjet në pika të veçanta , tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Zërat e punimeve në preventiv: Sipas emërimit në preventiv "F.v Gure 10x10x15 cm (Mozaik) > " për realizimin e mbishtësës së urës në pjesën e karrexhatës, auto.etj.	A	Niveli A i licencës pasi punimet e parashikuara janë më pak se 20 milion lekë
N.P. 11	Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore. Zërat e punimeve në preventiv: për punimet e ndërtimit "Ndricues LED te inkastruar ne toke TVDM-L301 White 9W >" dhe "F.v Ndricues I jashtem shtylle, Fumagalli, E27, H.237cm, D.33cm, rezin, e zeze >" , etj	A	Niveli A i licencës pasi punimet e parashikuara në preventiv janë më pak se 20 milion lekë
N.S.- 6	<i>Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, rishikimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.</i> Zërat e punimeve në preventiv: për sinjalistikën vertikale (tabelat) dhe atë horizontale "Vizime me boje bicomponente me gjeresi 15 cm"	A	Niveli A i licencës pasi punimet e parashikuara në preventiv janë më pak se 20 milion lekë
N.S.- 10	Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja dhe rishikimi i shtresave (dyshemeve) të realizuara me materiale të veçanta, natyrale ose artificiale, të cilat janë me ngarkesa të konsiderueshme. Zërat e punimeve në preventiv: "F.v Gure 10x10x15 cm (Mozaik) > "për realizimin e mbishtësës së urës në pjesë e karrexhatës, në të cilën realizohet qarkullimi auto. me ngarkese	A	Niveli A i licencës pasi punimet e parashikuara në preventiv janë më pak se 20 milion lekë

2.3.3. Stafi dhe punonjësit

A) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar drejtuesit teknik, që kanë në licencën e shoqërisë, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit (Shtator 2025) nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- Inxhinier me licence profesionale individuale "Projektues Ruge-Hekurudha 6-b" 1 (një)
- Inxhinier me licence profesionale individuale "Projektues Instalator 4-i" 1 (një)
- Inxhinier me licence profesionale individuale "Projektues të Sinjalizimit Rrugor 11-b" 1 (një)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqitet:

- *Të figurojë si komponent i listës së drejtuesve teknik në licencën e subjektit*
- *Licencën personale profesionale.*
- *Drejtuesit teknik të jenë të siguar sipas legjislacionit në fuqi, në listëpagesat e muajit të fundit që është kërkuar më lartë.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, çdo anëtar i grupit duhet të kenë të punësuar drejtuesit teknik dhe stafin mbështetës inxhiner, sipas zërave të preventivit, që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë.

B) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar në profesionet si më poshtë:

I. Specilistë ndërtimi

– Teknik Ndërtimi	1 (një)
– Elektriçist	1 (një)
– Hidraulik	1 (një)
– Saldator	1 (një)
– Topograf	1 (një)
– Bojaxhi	1 (një)
– Shtrues pllakash, muratorë,	
– apo të tjerë që lidhen me to	3 (tre)

II. Drejtues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe drejtues kamioni

– Eskavatorist / fadromist	1(një)
– Drejtues kamioni (autokamionist) me Leje drejtimi të tipi C	2 (dy)

Për specialistët e kërkuar më sipër (pika 2.3.3.B/I) të paraqiten:

- diplomë/ dëshmi/ certifikatë/ ose çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimin e tyre
- kontrata e punës, e vlefshme për të paktën, periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve
- të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, të paktën, për **muajin e fundit (Shtator 2025)** nga data e hapjes së ofertave.

Për drejtues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe drejtues kamioni (pika 2.3.3.B/II), të kërkuar më sipër të paraqiten:

- kontrata e punës, e vlefshme për të paktën, periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve;
 - Certifikatë Aftësimi Profesional për Përdoruesit e Makinerive të Rënda të Ndërtimit dhe Punimeve në Tokë nga DPSHTRR;
 - Leje Drejtimi kategoria C me Certifikatë Aftësimi Profesional nga DPSHTRR për drejtuesi kamioni;
 - të figurojnë në listepagesat e shoqërisë të paktën për **muajin e fundit (Shtator 2025)**, nga data e hapjes së ofertave.
-

- C) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar një numër, të paktën, prej **22 (njëzetë e dy)** punonjësish, përveç stafit drejtues menaxherial, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit (Shtator 2025) nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:
- Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e deklaruar

Argumentimi: Për pikat (A,B,C) kërkesa është bazuar në pikën 4 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39, pika 6, shkronja c dhe ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar mbi VKM nr.514 datë 20.09.2017 “PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP),TË RISHIKUAR”. Këto kritere lidhen ngushtësisht me objektin të kontratës si dhe në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin dhe grafikun e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri një i inxhinierëve sipas profilit, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në kryerjen e punimeve, duke ju referuar objektit, vendndodhjes gjeografike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast mund të çojë në mosrealizim në afat dhe me cilësi të dobët të punimeve. Personeli teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm për realizimin të kontratës.

STAFI DREJTUES TEKNIK (në licencën e subjektit)	Argumentimi
Inxhinier me licence profesionale individuale "Projektues Rruge-Hekurudha 6-b"	Sipas kërkesës së licencës NP4 për subjektin. Për drejtimin e punimeve në përgjithësi dhe sipas përcaktimeve në nr.759, datë 12.11.2014,"Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, i ndryshuar". Lidhja 2.
Inxhinier me licence profesionale individuale "Projektues Instalator 4-i"	Sipas kërkesës së licencës NP11 për subjektin. Për drejtimin e punimeve elektrike për ndriçimin rrugor dhe sipas përcaktimeve në nr.759, datë 12.11.2014,"Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, i ndryshuar". Lidhja 2.
Inxhinier me licence profesionale individuale "Projektues të Sinjalizimit Rrugor 11-b"	Sipas kërkesës së licencës NS6 për subjektin. Sinjalistika jo ndriçuese në rrugën kryesore urbane dhe sipas përcaktimeve në nr.759, datë 12.11.2014,"Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, i ndryshuar". Lidhja 2.

- D) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar/certifikuar,si dhe të figurojnë në listëpagesa për muajin e fundit, si më poshtë:
- 1 (një) punonjës që të disponojnë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.
 - 1 (një) punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë të lëshuar nga një organ i akredituar për dhënien e Ndihmës së Parë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8

Argumentimi: Në mbështetje të ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe VKM-në Nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier”, si dhe Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar.

2.3.4. Mjetet dhe paisjet

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë mjetet dhe pasijet e nevojshme për realizimin në kohë dhe me sukses të punimeve, si më poshtë:

	Paisje e makineri	Njësia	Sasia	Pronësia
1	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Sperkates boje per vizime ne rruge	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Kamione vetshkarkues me kapacitet >=20 ton (10m ³)	copë	2	Në pronësi ose me qera
4	Kamione vetshkarkues me kapacitet >=5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Minifadromë ose Miniekskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Autovinc deri në 2.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Motosaldatriçe	copë	1	Në pronësi ose me qera

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës nr. 8.** “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- (a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
- dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit, (çertifikata e pronësisë);
 - dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit);
 - çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
 - siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - leje transporti e vlefshme nga njësia vendore (sipas rastit)
 - foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij;
- (b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe:
- kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
- kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse
 - fotot
-

(d) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë kur janë me qira, krahas dokumentacionit të mesipërm, duhet të paraqitet:

- kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plotë të punimeve.

Shënim:

Në rastin kur fatura tatimore është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së, ajo duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin Publik", neni 77 "Kërkesat për kualifikim", pika 4, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 39 "Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike", pika 6 gërma d), si dhe në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin si dhe grafikun e detajuar të punimeve me kohët e punës, numrin e punonjësve, numrin e specialistëve, numrin e drejtuesve teknikë, licencat e nevojshme dhe makineritë dhe paisjet, të hartuar nga specialisti i fushës në njësinë e prokurimit), në tabelën më poshtë përshkruhet nevoja për paisjet dhe makineritë

Kriteri është në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin dhe grafikun e punimeve. Gjithashtu është në përputhje me natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës. Operatorët ekonomik kërkesat për pajisje në pronësi, mund të plotësojnë edhe duke i marrë ato me qira. Lidhur me paisjet Autoriteti Kontraktor ka patur parasysh projektin, preventivin dhe relacionin teknik. Këto paisje mund të sigurohen lehtësisht nga operatori ekonomik pasi janë me kosto relativisht të ulët dhe nuk përbëjnë kriter diskriminues.

Paisje e makineri	Njësi	Sasi	Zërat e punës në preventiv
Autobot	copë	1	<i>Pavarësisht se analiza 3.212/b parashikon grejder, autobot dhe rul, në këtë rast, mqs. kemi të bëjmë me sipërfaqe të kornizuar mbi urë, hapja dhe nivelimi i stabilizantit do të bëhet manualisht</i>
Sperkates boje per vizime ne rruge	copë	1	<i>Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm</i>
Kamione vetshkakues me kapacitet 20ton (10m³)	copë	2	<i>Per furnizimin e stabilizantit dhe gureve</i>
Kamione vetshkakues me kapacitet 5ton	copë	1	<i>Per largimin e materialeve qe hiqen dhe funizimet e materialeve te tjera</i>
Minifadrome ose minieskavator me goma	copë	1	<i>Për ngarkimin e materialeve qe hiqen</i>
Autovinc deri 2.5 ton	copë	1	<i>F.v Ndricues I jashtem shtylle, Fumagalli, E27, H.237cm, D.33cm, rezin, e zeze ></i>
Motosaldatrice	copë	1	<i>Për montimin "Zgara dekorativa hekuri mesatare"</i>

2.3.5. Kërkesat e cilësisë dhe standarteve

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme për periudhën e ndërtimit, si më poshtë **ose ekuivalente me to**:

- Certifikate ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë)
- Certifikate ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata (ose ekuivalente), në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 pika 1, AK kërkon cilësi dhe garanci të punimeve duke qenë se objekti është i një rëndësie të veçantë. Gjithashtu AK kërkon garantimin e shëndetit dhe sigurisë në punë, konform ligjeve dhe politikave të vendit tonë. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminues për operatorët.

Shënim: *Certifikatat e mesiperme/ekuivalente duhet të jenë të lëshuara nga Institucione të certifikuar/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombëtare dhe në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këto certifikata në përputhje me shërbimet që ka marrë persiper në marrëveshjen e bashkepunimit.*

3. TË PËRGJITHSHME

Pavarësisht sa përcaktohet në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe të paraqitura nga ofertuesi në formularin përmbledhës të deklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet Teknike

Objekti i prokurimit “**Rikualifikim i urës së Çorovodës**”, shoqërohet me projekt zbatimi të plotë, metodologjia e punës, specifikime teknike, grafik punimesh dhe preventiv punimesh.

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Skrapar, ka miratuar projektin e hartuar nga “**HE & SK 11**”, për rrjedhojë edhe **Specifikimet Teknike**.

Për pasojë, kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e realizuar, pasi specifikimet janë hartuar dhe miratuar paraprakisht.

Specifikimet teknike do të jepen bashkëlidhur Dokumenteve Standarte te Tenderit, për procedurën E hapur, E Thjeshtuar, Punë.

Përfundime

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit, si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte te Tenderit, për procedurën e hapur, punë me objekt prokurimi “**Rikualifikim i urës së Çorovodës**”.

Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së.

NJËSIA E PROKURIMIT

Altin Lamçe

Benis Dosti

Florand Osmani